



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**BURSA STUDIMI NË INDI**

**VITI AKADEMIK 2021-2022**

Ambasada e Indisë e akredituar në Rumani informon se janë hapur aplikimet për bursa studimi për vitin akademik 2021-2022 në Indi. Këto bursa ofrohen nga Këshilli Indian për Marrëdhëniet Kulturore (ICCR) dhe mbulojnë studime universitare dhe pasuniversitare në programe të ndryshme studimi, përjashtuar studimet për Mjekësi/Ndihmësmjekësi (Infermieri, Fizioterapi, Anestezi) dhe fushat e modës.

Në këtë thirrje ftohen të aplikojnë të gjithë kandidatët potencialë nga Shqipëria të grupmoshës 18-30 vjeç të cilët duhet të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze në mënyrë që të jenë të aftë të shprehen rrjedhshëm në anglisht dhe të kuptojnë mësimet në anglisht pa vështirësi.

E gjithë pagesa e shkollimit për këtë program bursash paguhet nga Këshilli Indian për Marrëdhëniet Kulturore (ICCR).

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të plotësojnë kriteret dhe formularin **online** që gjendet në *linkun* e mëposhtëm nëpërmjet portalit të bursave ICCR A2A (Admissions to Alumni) brenda datës **30 Maj 2021**.

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të programeve të studimit, formulari i aplikimit, si dhe informacione të tjera gjenden bashkëlidhur këtij njoftimi.

[www.a2ascholarships.iccr.gov.in](http://www.a2ascholarships.iccr.gov.in)

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE  
ASISTENCËS**